

KONCESIONE / PARTNERITET **PUBLIK PRIVAT**

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: Dhënie me koncesion te hidrocentralit "Kalivar"
 Forma e kontratës: B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)
 Lloji i kontratës: Pune
 Vendndodhja e objektit te kontratës: Interesi për shfrytëzimin hidroenergjetik është pellgun ujëmbledhës të përroit të Kimzës dhe Mesulit.
 Kohëzgjatja e kontratës: 35 vjet

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te ofruara:

1. Shoqëria "BE-IS" sh.p.k.
2. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "F.G.J.S Grup" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k.

Ofertat përmbledhëse, referuar Shtojcës nr. 1 te DSK, te plotësuar dhe te nënshkruara, paraqiten si me poshtë:

Nr.	Kriteret	Njësia e matjes	BE-IS sh.p.k.	JV "FGJS Grup" & "Nika"
1	Prodhim i vjetor i Energjisë Elektrike	kWh	24,474,521	14,170,827
2	Fuqia e instaluar	kW	5,472	3,270
3	Koha e zbatimit te punimeve	Muaj	12	12
4	Vlera e investimit (pa TVSH)	Leke	465,326,140	380,802,530
5	Kosto per njësi e makinerive dhe pajisjeve per KW fuqi te instaluar	leke/kW	40,000	39,623 ⁸⁵

6	Vlera e "Fee koncesionare" (e shprehur ne % te energjisë elektrike vjetore te prodhuar)	%	4.7	4
7	Vlera ne para qe i paguhet Autoritetit Kontraktor si rezultat i dhënies se te drejtës koncesionare	%	1	0.7

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "F.G.J.S Grup" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k.

Përkatësisht per arsyet e mëposhtme:

Per mos plotësim te kriterave ligjore, ekonomiko-financiare dhe teknike kualifikuese sipas shtojcës 9 te DSK dhe konkretisht:

- a) Ne Akt – Marrëveshjen per Bashkimin e Përkohshëm te shoqërive me nr. 845 rep. & nr. 391 kol. date 18.5.2015, me ane te se cilës janë bashkuar shoqëritë "F.G.J.S Grup" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k. per këtë procedure konkurruese, ne paragrafin e fundit citohet se: "Ky shoqërizim i përkohshëm i shoqërive do te jete automatikisht i shkrirë pa kryer formalitete te tjera kur:

Ne rast se nuk shpallet fitues i kontratës se sipërpërmendur;

Ne rast kur shpallet fitues;

Me marrjen e certifikatës se kolaudimit;

Me likuidimin e te gjithë detyrimeve te kontratës përfshi garancinë;"

Duke qene se ne njoftimin e kontratës është shprehur qarte se kohëzgjatja e kontratës është 35 vjet, nuk mundet dhe nuk ka kuptim qe një bashkim i përkohshëm i krijuar posaçërisht per përmbushjen e kësaj kontrate te jete automatikisht i shkrirë pa kryer formalitete te tjera ne rast se shpallet fitues apo me marrjen e certifikatës se kolaudimit.

- b) Ortaket e shoqërisë "F.G.J.S Grup" sh.p.k. nuk e kane shprehur qarte vullnetin e tyre nëpërmjet një vendimi per te hyre ne marrëveshje te bashkimit te përkohshëm te shoqërive. Pra, ne kundërshtim me sa parashikohet tek seksioni i "Bashkimit te përkohshëm te shoqërive" i pikës 2.1. "Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë" te shtojcës 9, kjo shoqëri nuk ka paraqitur vendim te ortakeve te shoqërisë per te hyre ne marrëveshje te bashkimit te përkohshëm te shoqërive. Teksojmë se kjo shoqëri përbëhet nga 2 ortake me pjesëmarrje te 50% te kuotave te kapitalit themeltar.
- c) Shoqëria "F.G.J.S Grup" sh.p.k. nuk ka paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, por ne vend te saj është paraqitur Deklarata Noteriale nr. 2133 rep & nr. 748 kol. date 22.5.2015 me ane te se cilës deklarohet se te gjitha detyrimet per energjinë elektrike janë paguar, gjë qe është ne kundërshtim per sa është kërkuar ne DSK.
- d) Shoqëria "F.G.J.S Grup" sh.p.k. nuk plotëson kriterin financiar dhe teknik kualifikues per pjesën e marre përsipër prej 1% ne Akt – Marrëveshjen per Bashkimin e Përkohshëm te shoqërive me nr. 845 rep. & nr. 391 kol. date 18.5.2015.

* * *

Ministria e Energjisë dhe Industrisë lajmëron **Z. Hamz Islamaj**, Shoqëria "BE-IS" sh.p.k., me adresë: Lagja nr. 5, Pallati nr. 23, Hyrja nr. 1, Ap. 10, Kati IV, Tirane, se oferta e paraqitur më datë 26 Maj 2015, për marrjen me koncesion të hidrocentralit Kalivar, është pranuar.

Afati i negociimit të Kontratës tuaj do të jetë 60 dite nga marrja e njoftimit të fituesit.

Shoqëria "BE-IS" sh.p.k. kërkohet t'i paraqesë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

- ☐ Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare/Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
- ☐ Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat Standarte të Procedurës Konkurruese, në vlerën e 10% të Investimit të propozuar në oferte. Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- ☐ Dokument bankar që vërteton pagesën e kryer e "vlerës në para" në përputhje me ofertën tuaj. Kjo pagese do të kryhet para fillimit të negociatave.
- ☐ Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim brenda 10 (dhjetë) diteve nga marrja dijeni.

Afati për dorëzimin e dokumentave të sipërpërmendur do të jetë jo më vonë 20 dite nga marrja dijeni.

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.7.2015

Ankesa: Po, ka. Nepërmyet shkresës nr. 5386 prot., datë 29.7.2015, pranë Autoritetit Kontraktues (Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë) është paraqitur "Formulari ankesës drejtuar Autoritetit Kontraktues" nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "F.G.J.S Grup" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k. dhe ka marrë përgjigje në datë 3.8.2015